- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit **Kontraktor [vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
 - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 2. Njoftimin e Kontratës;
 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

⁴Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [**Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë**];
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [**Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë**];

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

[Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët, nga operatori ekonomik plotësohet dhe paraqitet vetëm kjo Shtojcë]

FORMULARI I OFERTËSEKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomikshënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;

⁵Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

d) Norma e fitimit e shprehur nëvlere absolute është si më poshtë

1	2	3
Nr	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomike më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti kontraktor përllogarit çmimin bazuar në:

- a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date;
- b) elementet fiskale;
- c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;

Shtojca3.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: _____

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallratduhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimevepër artikujt. Artikujt pa vlerëdo të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të çojë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njesi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet)*: Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]/Nr.Referencës në faqen e APP-së*.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca5.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit**Nënshkrimi****Vula**

Shtojca6.

[Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Nr	EMERTIMI	Njesia	Sasia
1	Pemë e llojit Blin (Tilia Platyphyllos), me perimetër 20-25 cm, lartësi nga toka 2 e 20- 2 e 30 cm. lartësi totale 3.5-4 M.	Copë	253

1. Çdo pemë duhet te ketë formë të rregullt, trangu i pemës duhet të jetë pa plagë, i pa deformuar dhe i drejtë, të mos jenë të dëmtuara nga agjentët atmosferikë dhe të pa infektuara nga sëmundje të ndryshme.

2. Të jenë në vazo plastike të paktën mbi 1 vit të mbjella.
3. Lartësia e pemëve dekorative të jetë mbi 3 metra.

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet: 253 Copë BLIN.

Afatet e lëvrimit: Nga data e lidhjes së kontratës deri në 10 ditë. Vendi i depozitimit të mallit prane Magazinës së Agjencisë së Shërbimeve Publike. Parashikohet ashtU si është percaktuar në DST **25-30 Bimë në ditë.**

Artikulli	Përshkrimi	Shuma	Destinacioni	Periudha e dorëzimit

Shtojca 8.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfasuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

2.2 Për kapacitetin ekonomik dhe financiar Ofertuesit duhet të paraqesin:

2.2.1 Ofertuesi duhet të dorëzojë:

Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021-2022-2023) ku vlera e xhiros për të

paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar **duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së parashikuar në kontratë (jo më pak se 1.318.130 Lek)**. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim

***Argumentimi:** Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në pikën 1, 2 dhe 3, të nenit 43, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e marzhit të xhiros së kërkuar në kufirin e përcaktuar më sipër, konsiderohet tregues i rëndësishëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes së kapaciteteve ekonomike dhe financiare të Operatorëve Ekonomikë ofertues, në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përveç bazës ligjore të sipërcituar, ky kriter është në përputhje edhe me legjislacionin e fushës, konkretisht, me përcaktimet e bëra në Ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe në kërkesat e Ligjit Nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29, të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, përcaktohet se: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin **bilancet vjetore** për vitet financiare **2021, 2022, 2023** të paraqitur pranë autoriteteteve përkatëse. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

***Argumentimi:** Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

Raporti pozitiv ndërmjet aktivitetit dhe pasivit të bilanceve të dy viteve të njëpasnjëshme, konsiderohet tregues i rëndësishëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes së kapaciteteve ekonomike dhe financiare të Operatorëve Ekonomikë ofertues, në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përveç bazës ligjore të sipërcituar, ky kriter është në përputhje edhe me legjislacionin e fushës, konkretisht, me përcaktimet e bëra në Ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin

mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe në kërkesat e Ligjit Nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29, të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, përcaktohet se: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për **furnizime të ngjashme** në një vlerë jo më të vogël se **659.065 lek, 20% e vleres se perlllogaritur te kontrates**, qe prokurohet dhe qe eshte realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.

Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme:

- a) **Ne rastin e pervojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik**, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të leshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasi të mallrave të furnizuara, dhe të jenë të deklaruar në organet tatimore

ose

- b) **Në rast se përvoja e mëparshme është realizuar me sektorin privat**, si dëshmi do të pranohen vetëm fatura tatimore shitje, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasi të mallrave të furnizuara dhe të jenë të deklaruar në organet tatimore.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në pikën 4, të nenit 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit.

Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumnin e saj dhe shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor për të njohur gjendjen dhe kapacitetet e Operatorëve Ekonomikë ofertues, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Përvoja e mëparshme është një element i rëndësishëm që garanton Autoritetin Kontraktor, se Operatorët Ekonomikë mbi bazën e vlerës së furnizimeve të ngjashme zotërojnë kapacitetet e nevojshme për të zbatuar

kontratën me sukses sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Kjo kërkesë është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e objektit të prokurimit dhe njëkohësisht është brenda periudhës dhe vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqes dëshmi të testimve zyrtare për mallrat objekt prokurimi të lëshuara nga Institucionet zyrtare dhe konkretisht si me poshtë:

2.3.2: Autorizim lëshuar nga Autoriteti Çertifikues **ENTI SHTETOR I FARËRAVE dhe FIDANËVE** për nxjerrjen e **etiketave** të furnizuesit.

2.3.3: Çertifikatë origjine lëshuar nga **ESHFF** ose në rastet kur Op ekonomik nuk është prodhues duhet të vërtetohet me Marrëveshje Bashkëpunimi ose ekuivalente me të, të zyrtarizuar e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose lidhjen midis ofertues-distributor-prodhues, ku ky i fundit duhet të përmbaje të dhëna të plota për identifikimin e tij/saj.

2.3.4: Në rast se bimët janë import ato duhet të jenë të shoqëruar **me çertifikatë fitosanitare dhe çertifikatën e prodhimit.**

2.3.5: Çertifikatë zyrtare lëshuar nga Autoriteti **ENTI SHTETOR I FARËRAVE dhe FIDANËVE**, i cili çertifikon fidanishen përkatëse.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar në nenin 40, pika 6/c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ndryshuar me VKM Nr. 485 dt 01.08.2024 ku citohet: ” dëshmi për rezultatet e testimve zyrtare të lëshuara nga institucione të autorizuar që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. Në rastin konkret kemi të bëjmë me një kërkesë minimale lidhur me një dokument cilësie për materialet që AK kërkon të blejë. Dokumentat e kërkuara me lart janë lehtësisht të siguruara nga ana e Op Ek që operojnë në këtë fushë dhe madje të detyrueshme që ato të veprojnë konform ligjit, respektojnë parimin e mosdiskriminimit, me kosto të ulët. Këto kritere janë të vendosura në mbështetje të ligjit specifik dhe konkretisht **Ligji Nr. 10416 dt 07.04.2011 ‘ Për Materialin mbjellës dhe dhe shumëzues Bimor’, Ligji Nr. 105/2016 ‘ Për Mbrojtjen e bimëve’ i ndryshuar si dhe VKM Nr. 523 dt 13.07.2016 ” Për përcaktimin e kritereve të tregtimit e çertifikimit të materilaeve të shumëzimit dhe fidanëve të bimëve zbukuroese**”. Referuar kësaj baze ligjore fidanët e bimëve zbukuroese mund të tregtohen nëse; d) janë të pajisur me çertifikatë fitosanitare sipas modelit të përcaktuar në legjislacionin në fuqi për mbrotjen e bimëve dhe me çertifikatë zyrtare lëshuar nga Autoriteti Çertifikues.

2.3.6: Op ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar :

-
- a) **1 (Një) Agronom.**
 - b) **1 (një) Punonjës drejtues mjeti.**

- a) **Për agronomin** Op ekonomik ofertues duhet të paraqesë, 1) Kontratë pune të vlefshme, 2) Diplomë, 3) CV, 4) librezë Pune.
- b) **Për shoferin** Op ekonomik ofertues duhet të paraqesë, 1) Kontratë pune të vlefshme, 2) Diplomë, 3) CV, 4) librezë pune 5) dëshmi e aftësisë profesionale/patentë manovrimi lëshuar nga DPSHTRR.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Shënim: *Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin përkatës, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, sasinë e konsiderueshme të mallrave që po prokurohet dhe gjithashtu garanton një furnizim me cilësi dhe në kohë. Punësimi i një agronomi prane Op ekonomik ofertues shërben për ti dhënë garanci AK që bimët objekt prokurimi përmbajnë cilësinë e kërkuar, i janë realizuar të gjitha shërbimet e nevojshme që në gjenezë të saj në mënyrë që bima të zhvillohet në mënyrë të shëndetshme por gjithashtu shërben për të garantuar që bima i përmbahet specifikimeve që janë kërkuar. Nisur nga fakti që Op ekonomik është i detyruar të transportojë mallrat objekt prokurimi prane AK është e domosdoshme që Op ekonomik ofertues të disponojë në listpagesat e saj një shofer.

2.3.7: Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e objektit të prokurimit, duhet të vërtetojë/disponojë që ka të punësuar mesatarisht **6 (gjashtë) persona, ku përfshihen Agronomi, shoferi.** Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit disponimin e numrit minimal të punonjësve.
Për të dëshmuar fuqinë punëtore operatori ekonomik duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë:

- a) Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi të muajit të fundit.
- b) Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni tatimor për muajin e fundit.

2.3.8: Op ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka në pronësi ose me qera:

1 (Një) Kamion me vinç të integruar ne të me peshë deri ne 7,5 ton.

Për mjetet që shënohen në regjistrat publikë, kur janë në pronësi duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit, leje qarkullimi, certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit (të vlefshme) dhe certifikata e transportit të mallrave të lëshuar nga bashkia përkatëse (**shoqëruar me foto përkatëse te mjetit**). Ndërsa në rastin kur mjetet janë me qira, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet dhe kontrata e qirasë e noterizuar, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Shënim: *Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.*

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në pikën 5, të nenit 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se kanë minimalisht (në pronësi ose të siguruar me qira) mjetin e nevojshëm për lëvrimin e mallit të kërkuar nga AK, me qëllim për të përmbushur kontratën objekt prokurimi. Lloji i mjetit (në pronësi ose të siguruar me qira), është vlerësuar si e nevojshme, në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke iu referuar sasisë së mallit objekt prokurimi, dhe afatit të lëvrimit të mallrave objekt kontrate. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike sa i përket mjeteve të kërkuara, gjë për të cilën janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqiten. Nisur nga afati lëvrimit të mallit që është përcaktuar në **10 ditë** dhe tonazhi i mjetit është llogaritur që ky mjet të transportojë një sasi prej **20-25 bimë në ditë nisur dhe nga vëllimi që zënë bimët,** (

total 253 Bimë). Mjeti kamion me vinç të integruar ne të me peshë deri ne 7,5 ton është në përputhje me natyrën, volumin dhe afatin e lëvrimin të mallit dhe lidhen ngushtësisht me procesin e transportimit të mallrave të kërkuar.

2.3.9: Operatori/ët ekonomik duhet të paraqesin çertifikatat e cilësisë së mallit, të vlefshme (ose ekuivalente) per objektin qe prokurohet, si më poshtë:

ISO 9001:2015	ose ekuivalente	Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë
ISO 14001:2015	ose ekuivalente	Sistemet e Menaxhimit Mjedisor
ISO 45001-2018	ose ekuivalente	Sistemi i Menaxhimit te Shëndetit dhe
Sigurisë në Punë		

Të gjitha çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kerkesat e mesiperme jane vendosur bazuar ne Nenin 79, pika 1 te Ligjit Nr. 162/2020, “Per prokurimin publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”,si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”

Ky kriter kërkohet që OE është i certifikuar sipas standartit ndërkombëtarë që produktet apo paisjet e sjella janë të garantuara në cilësi dhe nuk janë produkte të pakontrolluara apo të fallsifikuara

2.3.10 Op Ekonomik ofertues duhet të dëshmoje se disponon ambient të përshtashëm qoftë i brendshëm apo jashtëm (**foto bashkëngjitur ne sistem**), ku mban bimët objekt prokurimi, dhe që i mban ato në kushte optimale lidhur me furnizmin me ujë dhe plehrimin përkatës, mbrojtjen nga agjentët atmosferik etj.

Lidhur me ambientin Op Ekonomik ofertues duhet të paraqes dokumentacionin përkatës të pronësisë (**Certifikatë pronësie lëshuar nga ASHK në emër të Op Ekonomik**), ose në rastin kur e ka me qera **Kontraten e qirase dhe gjithashtu bashkëngjitur dokumentat e pronësisë së pronës**.

2.3.11: Operatori/ët Ekonomik duhet të paraqes/in **deklaratë** që furnizimi do të behet me mjetet dhe shpenzimet e operatorit ekonomik fitues brenda afatit të percaktuar nga Agjencia e Sherbimeve Publike Bashkia Berat prane ambienteve të ASHP berat.

2.3.12: Operatori ekonomik ofertues duhet të përgjigjet në lidhje me të metat, defektet që ka malli objekt prokurimi. Garancia e mallit do të jetë **3 muaj** duke filluar nga data e marrjes në dorëzim të mallit nga Autoriteti Kontraktor

2.3.13: Op ekonomik ofertues duhet të paraqes **mostër** për objektin e prokurimit deri ditën e hapjes së ofertave.

Mosparaqitja e mostrave deri ne ditën dhe oren e hapjes se ofertave përbën kusht për s’kualifikim.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/a dhe c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku citohet: ” **Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:**

- a) **mostra të mallit**, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në rastin konkret AK e çmon të nevojshme administrimin e mostrave me qëllim që të krijojë një ide të saktë në lidhje me përputhshmërinë e mallrave me specifikimet teknike.

3. Argumentimi i specifikimeve teknike

Argumentim: Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 15, pika 3/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Specifikimet teknike hartohen nga grupi i punës ngritur me Urdherin e brendshëm Nr. 172 dt 18.09.2024 dhe 544/1 Prot, me specialist fushe Adriatik Meçe për objektin që prokurohet.

Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Nr	EMERTIMI	Njesia	Sasia
1	Pemë e llojit Blin (Tilia Platyphyllos), me perimetër 20-25 cm, lartësi nga toka 2 e 20- 2	Copë	253

e 30 cm. lartësi totale 3.5-4 M.		
----------------------------------	--	--

4. Çdo pemë duhet të ketë formë të rregullt, trungu i pemës duhet të jetë pa plagë, i pa deformuar dhe i drejtë, të mos jenë të dëmtuara nga agjentët atmosferikë dhe të pa infektuara nga sëmundje të ndryshme.
5. Të jenë në vazo plastike të paktën mbi 1 vit të mbjella.
6. Lartësia e pemëve dekorative të jetë mbi 3 metra.

Malli i kërkuar sipas tabelës me zërin përkatës duhet të përgjigjet kerkesave teknike, duhet të jete **me cilesi**. Per rastet e difekteve te fshehta pergjegjësia është e Op Ekonomik.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 9.*(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)***FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
 _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

•
nformacion mbi subjektet

mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, **Deklaroj Se:**

Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër⁶.

⁶Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencën, në lidhje me:

- a) çmimet;
- b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
- c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
- d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.

Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj.

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

